



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2019:113996
Datë: 07.10.2020
Numri i dokumentit: 01168736
C.nr.171/17

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ –Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me sekretaren juridike Azemine Berisha, punëtore e kësaj gjykate, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit Xh. Z nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut, kundër të paditurës Republika e Kosovës-Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit tani Ministria e Infrastrukturës me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Naim Krasniqi avokat shtetërorë, për çështjen kontestuese kompensim i demit, në seancën kryesore të mbajtur me datën 23.09.2020, në praninë e paditësit dhe në mungesën e të paditurës ndërsa me datën 07.10.2020, bëri përpilimin me shkrim të këtijë:

A K T G J Y K I M

I MIRATOHET, kërkesëpadia e paditësit N.Z nga fshati..., Komuna e Kaçanikut dhe DETYROHET e paditura Republika e Kosovës-Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit tani Ministria e Infrastrukturës me seli në Prishtinë, që paditësit të i'a paguaj shumën prej 8.706.13 € në emër të kompenzimit të demit material për largimin e dheut, i cili ka qenë i deponuar në ngastrën kadastrale Pk.nr.570, fleta e posedimit numër 20 Z. K...B .. Komuna e Kaçanikut, në tërsi SI E BAZUAR

Këtë shumë me kamatë si për mjetet e deponuara në bankat afariste, pa destinacion të caktuar në afat prej më shumë se një vit duke filluar nga data 03.06.2009, e gjerë në pagesën definitive.

II Detyrohet e paditura që paditësit të i'a paguaj shumën si në pikën I të dispozitivit të aktgjyqimit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 602 €, të cilat pagesa do të bëhen në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi si në padi ashtu edhe në seancën përgatitore dhe në shqyrtimin kryesorë ka kërkuar nga gjykata që kërkesë padinë e paditësit ta miratojë në tërësi si të bazuar. Ka theksuar se paditësi me të paditurën janë marrë vesh që e paditura ta bëjnë grumbullimin e dheut në parcelën nr.570- fleta e posedimit nr.20 Z.K. B..., Deponimi i dheut është bërë deri sa të përfundojnë punimet për hapjen e rrugës Kaçanik-Hani Elezit , e pastaj do të bëhet largimi i dheut nga parcela.

Po ashtu ka theksuar se edhe përkundër disa përpjekjeve, për ta zgjidhur këtë çështje me marrveshje me të paditurën nuk kanë mundur që këtë çështje ta zgjidhin me marrveshje, prandaj është detyruar që të drejtohet gjykatës dhe të kërkojë mbrojtje gjyqësore.

Po ashtu ka theksuar se tani nuk e kërkon kthimin në gjendje të më parshme, të ngastrës sepse ngastra kontestuse është shpronasuar dhe një kërkesë e tillë është e pa arsyshme, prandaj kërkojmë që dëmi i cilin na është shkaktuar të paguhet në mjete financiare, sepse ato mjete janë paguar për largimin e dheut dhe ne si palë paditëse kemi pësuar dam material në shumën e kërkuar.

Ka theksuar se nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe deklarata e dëshmitarëve, është vërtetuar se ky dëm paditësit i është shkaktuar me fajin e të paditurës. Prandaj nga këto baza i ka propozuar gjykatës që kërkesë padinë ta miratojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar .

Gjykata shqyrtimin kryesor e ka mbajtur në mungesën e të paditurës, sepse e njejtë është ftuar me rregull, ndërsa me parashtres i ka propozuar që të vazhdohet me seancë gjyqësore , gjykata seancën e ka mbajtur sepse janë plotësuar kushtet nga neni 423.4 të LPK-së

E paditura është deklaruar përmes parashtresës dhe ka theksuar se pala paditëse, ka bere pretendime plotësisht të pa bazuar dhe paqëndrueshme për nga gjendje faktike ne drejtim te Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit të Republikës së Kosovës.

I autorizuari i të paditurës, ka theksuar se Ministria ju ka përmbajtur marrëveshjes dhe nuk qëndrojnë theksimet paditësit i cili pretendon se ka pasur dëme si pasoj e mos largimit te dheut. Këto pretendimet te paditësit te cilat ishin miratuar nga gjykata ne shkalle te pare pas ankese se bazuar lënda është kthyer ne rigjykim dhe kërkojmë nga gjykata ti përfille rekomandimet e Gjykatës se Apelit sepse nuk është duke i shkaktuar dëme paditësit. Prandaj i ka propozuar gjykatës, qe pas administrimit të provave të refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit si e pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në këtë çështje juridike civile me propozimin e palëve ndërgjyqëse e zhvilloi procedurën e provave duke e bërë leximin e këtyre provave të shkruara: u lexua marrëveshja 08 Nr.395/06, procesverbali i datës 03.03.2006,fleta posedimit nr. 20, procesverbali i vende shikimit i datës 13.05.2009, ekspertiza e datës 19.05.2009, plan rilevimi i ternit, fotografitë e vendit të ngjarjes, përgjigja në padi e datës 03.05.2009, shkresat nga drejtoria e rrugëve, ankesa e datës 26.06.2009, deklaratat e dëshmitarëve A.I dhe Z. Z, deklarata e paditësit e dëgjuar në cilësi e palës dhe mendimi e ekspertit të gjeologjisë, dhe deklarimi për seancë , pa pyetje dhe pa vërejtje .

Pas analizimit të provave në tërësi dhe të secilës veç e veç si dhe konform nenit 8 të LPK-së dhe bindjes së lire të gjykatës, gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Paditësi është pronar i ngastrës kadastrale numër 570, e cila gjindet në Z.K B..., në këtë ngastër e paditura e ka bërë deponimin e dheut me rastin e hapjes së rrugës Kaçanik-Hani i Elezit. E paditura ka marrë detyrim që pas përfundimit të punimeve në rrugë ta bëj largimin e dheut të deponuar në këtë ngastër, e paditura nuk e ka bërë largimin e dheut sipas marr veshjes. Paditësi nga veprimet e të paditurës ka pësuar dëm, e për ta sanuar këtë dëm –larguar dheun paditësit i shkaktohet dëm material në vlerë prej 8.706.13 €.

a) Se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale me Numër 570 Z.K B..., këtë fakt gjykata e vërtetoi nga fleta e posedimit numër 20, e lëshuar nga zyra kadastrale në Kaçanik. Në këtë është shënuar se kjo pasuri është e paditësit , po ashtu ky fakt është vërtetuar edhe nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë si dhe nga procesverbali i vendshikimit të datës 13.05.2009 , ku është shënuar se dhe është i deponuar në parcelën e paditësit , e i cili fakt nuk ishte kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse.

b). E paditura me marrëveshje me paditësin e ka bërë deponimin e dheut në ngastrën kadastrale Nr.570 në vendin e quajtur “V...” me kulturë ar e klasës 7 , në sipërfaqe prej 0.27.82 ha, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga procesverbali 08 Nr 395 prej datës 03.03.2006, në të cilin procesverbal është shënuar që dheu i deponuar përkohësisht në pronën e paditësit do të largohet respektivisht prona të kthehet në gjendjen e mëparshme, e të cilin procesverbal e ka nënshkruar përfaqësuesi i të paditurës, paditësi dhe anëtarët e komisionit. Po ashtu këtë fakt gjykata e ka vërtetuar edhe nga deklarata e paditësit , i cili ka deklaruar se me të paditurën janë marrë vesh që dheu të vendoset përkohësisht në një pjesë të ngastrës kadastrale , e kjo më së miri vërehet nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë , ku është skicuar se ku është vendosur dheu.

c) Se e paditura ka marrë për detyrim që pas përfundimit të punimeve në hapjen e rrugës, magjistrales Kaçanik –Hani i Elezit, të bëhet largimi i dheut të deponuar, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga procesverbali 08 Nr 395 prej datës 03.03.2006. Në këtë procesverbal është shënuar që dheu i deponuar përkohësisht në pronën e paditësit të largohet respektivisht prona të kthehet në gjendjen e mëparshme , e të cilin procesverbal e ka nënshkruar përfaqësuesi i të paditurës , paditësi dhe anëtarët e komisionit, Po ashtu këtë fakt gjykata e ka vërtetuar edhe nga deklarata e paditësit , i cili ka deklaruar se me të paditurën janë marrë vesh që dheu të vendoset përkohësisht në një pjesë të ngastrës kadastrale , e kjo më së miri vërehet nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë , ku është skicuar se ku është vendosur dheu , kjo vendosje e dheut është bërë ,sepse palët ndërgjyqëse gjatë fillimit të sanimit të rrëshqitëzës gjegjësisht hapjes së rrugës Kaçanik –Hani i Elezit janë marrë vesh që pas përfundimit të punimeve dheu të largohet , po ashtu ky fakt se ku është vendosur dheu vërehet edhe nga dy fotografi të datës 17.05.2009 , të cilat gjenden në shkresat e lëndës .

d).Se me veprimet e të paditurës , paditësi ka pësuar dëm sepse prona e tij është bërë e pa shfrytëzueshme , këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës edhe atë 2 fotografi të datës 17.05.2009 , ku shihet se e paditura e ka bërë deponimin e

dheut në sasi prej 1.896.35 m³, e çka na rezulton se paditësit nga e paditura ju ka pamundësuar shfrytëzimin e një pjese të ngastrës kadastrale së tij të përshkruar më lart.

ç). Se largimi i dheut nga ngastra paditësit do t'i shkaktonte dëm material në shumë prej 8.706.13 €, këtë fakt gjykata e ka konstatuar nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, i cili në ekspertizën e tij ka konstatuar se sasia e dheut të deponuar është bërë në parcelën nr 570, e cila është pronë e Xh. Z nga fshati..., dhe përfshinë një sipërfaqe prej 600.11 m² dhe lartësinë mesatare prej 3.16 metra, e kur të llogaritet në sasi dheu i deponuar në këtë sipërfaqe është 1896.35 m² e kostoja e largimit të sasisë së dheut të deponuar në këtë parcelë arrin vlerën në shumë prej 8.706.13 €. Po ashtu këtë fakt gjykata e ka vërtetuar edhe nga ekspertiza e ekspertit të gjeologjis M.H, i cili ka konstatuar se e mbështet në tërsi ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë.

Gjykata gjykata pasë analizimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, kërkesëpadinë e paditësit e miratoi në tërësi si të bazuar dhe e detyroi të paditurën që t'ia paguaj dëmin material në shumë prej 8.706.13 €, Gjykata e detyroi të paditurën ta paguaj këtë damë sepse paditësit pasuria e tij gjegjësisht ngastra pk.nr. 571 i është bërë e pa shfrytëzueshme me veprimin e të paditurës sepse e njejtja e ka bërë deponimin e dheut e të cilin nuk e ka larguar, a ka pasur për detyrim ta largojë. Pastaj e paditura me marrëveshjen 08-NR-395/06, të datës 03.03.2006, si dhe procesverbalin e datës së njejtë dhe numër të njejtë ka marrë për detyrim që dheun e deponuar ta largojë dhe ngastrën kadastrale ta kthejë në gjendej të mëparshme. Po ashtu ky fakt është vërtetuar edhe nga deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar gjatë shqyrtimeve gjyqësore të cilët kanë deklaruar se ka qenë obligim i të paditurës që ta bëjë largimin e dheut.

Gjykata sa i përket lartësisë së dëmit dhe caktimit të shumës e ka marrë për bazë ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë dhe ekspertizën e ekspertit të gjeologjisë, të cilit kanë konstatuar se kostoja për largimin e dheut nga ngastra e paditësit arrinë shumën prej 8.706.13 €. Këtyre ekspertizave gjykata u a dha besimin sepse edhe eksperti i gjeologjis e ka mbeshtrut ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë sepse nuk ka pasur mundësi që ti bajë matjet sepse nëpër atë ngastër tani është ndërtuar auto-udhe dhe nuk mundë të bahen matjet sepse prona është marrë.

Gjykata kësaj ekspertize ja fali besimin sepse e njëjta pasqyron një gjendje reale, e njeta është bazuar në ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë , sepse eksperti i gjeologjisë nuk ka pasur mundësi që të bajë matjet e sasisës së dheut sepse në atë ngastër tani është ndërtuar autostrada. Pastaj mendimit të ekspertit të gjeologjisë gjykata ja fali besimin sepse i njëjti është bazuar në ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë, i cili i ka bërë matjet në teren dhe e ka konstatuar gjendjen faktike. Pastaj këtë mendim të ekspertit palët ndërgjyqse nuk e kanë kontestuar, e në veqanti pala e paditur asë me parashtrës nuk e ka kontestuar e asë nuk ka marrë pjesë në seancën gjyqësore, ku ka pasuru mundësi që ekspertit ti parshtrroj pyetje lidhur me mendimin e dhën me shkrim dhe të kërkoj sqarime.

Prandaj gjykata duke i pasur për bazë këto fakte të konstatuara dhe dispozitat e nenit 154 al 1 të LMD-së si dhe nenit 185 të LMD-së dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me kërkesën e palës paditëse dhe meqenëse e paditura ka rënë në vonesë me kompensimin e dëmit, gjykata me kërkesën e paditësit dhe në bazë të nen.277 të LMD-së, e detyroi të paditurin që paditësit në shumat e gjykuara t'ia paguaj edhe kamatën si për mjetet e deponuara në bankë pa destinacion të caktuar për më shumë se një vit edhe atë duke filluar nga data 03.06.2009 , e deri në pagesën definitive.

Gjykata i analizoi theksimet e palës paditëse, i cili i propozoi gjykatës që kërkesëpadin e paditësit ta miratojë në tërsi si të bazuar, e të cilave theksime gjykata ia fali besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata këtyre theksimeve jav dha besimin sepse nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës gjykata, ka gjetur se e paditura ka marrë detyrim që dheun e deponuar ta largojë dhe ngastrën kadastrale e paitësit dhe të njëjtën ta kthejë në gjendjen e mëparshme. Këtë fakt gjykata e ka vërtetuar edhe nga marrëveshjen e datës 03.03.2006, e nënshkruar nga F.G, punëtor i të paditurës dhe tani paditësit Xh.Z, po ashtu ky fakt është vërtetuar edhe nga procesverbali i datës 03.03.2006. Prandaj gjykata duke i marrë për bazë këto fakte vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata i analizoi edhe theksimet e të paditurës të bëra në seancat në të cilat kanë prezentuar dhe të bëra me parashtrësën e datës 22.09.2020 ku i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar, mirëpo gjykata këto theksime

nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes , sepse ky dëm është shkaktuar nga e paditura gjegjësishtë kompania e cila është kontraktuar nga e paditur për kryerjen e punëve.

Gjykata këto theksime nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes, sepse nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës edhe atë nga marrëveshja dhe procesverbali i datës 03.03.2006 , ka gjetur se paditësi ka bërë marrëveshje me të paditurën që e paditura ta bëj largimin e dheut të deponuar në ngastrën kadastrale Nr. 570, e cila është pronë e paditësit. ndërsa sa i përket theksimeve se kompetent për kompensimin e dëmit është NTP “B..”, këtë fakt gjykata nuk e pranoi për arsye se NTP “B..”, nuk ka bërë marrëveshje me paditësin për deponimin e dheut , por e njehta ka pasur kontratë me të paditurin vetëm për mirëmbajtjen e rrugëve. Prandaj gjykata duke i pasur për bazë të gjitha këto fakte të konstatuara , vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

Gjykata e detyroi palën e paditur që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 502 € sipas aktgjykimit C.nr.80/10, të datës 01.07.2013 dhe shumë prej 100.00 €, në emër të ekspertizës së ekspertit të gjeologjisë, të parapara sipas udhëzimit administrativ 01/2017, të Këshillit Gjyqësor për Unifikimin e taksave gjyqësore.

Gjykata vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka bazuar në nenin 452.1, të LPK-së.

Nga sa u theksua më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

C.nr.171/17 prej datës 23.09.2020

GJYQTARI

Riza LIVOREKA

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes. Ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.

Numri i lëndës: 2019:113996
Datë: 07.10.2020
Numri i dokumentit: 01168736